



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

## **RAPORT - FINAL**

**MBI**

# **AUDITIMIN E KOMBINUAR TË VEPRIMTARISË NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT QARKUT KORÇË**

**Grupi i auditimit**

**Arbëresha ZYKA**

**Flamur ÇELA**

**Natasha URUÇI**

**Qershor 2018**

regjistrit të riskut, ishte bërë vlerësimi dhe kontrolli i risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të seksioneve/sectorëve/zyrave.

Nga ana e institucionit është hartuar Rregullorja e Brendshme e Institucionit dhe është miratuar nga Titullari i Institucionit me Urdhër nr. 22/1 datë 15.05.2016, Rregullorja e Brendshme e Institucionit është hartuar në përputhje me strukturën dhe organiken e miratuar dhe aktuale, janë përfshirë të drejtat dhe detyrimet për cdo pozicion pune sipas përshkrimeve të punës të miratuara. Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore sipas sektorëve përkatës të funksionimit të këtij institucioni.

*Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin e përgjithshëm se kjo organizatë, ndonëse është përpjekur për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushat përkatëse, ka vend për identifikimin e kontrolleve të munguara, forcimin e kontrolleve ekzistuese, vlerësimin e riskut e trajtimin e tij, kjo referuar gjetjeve të konstatuara të trajtuara në Projekt Raportin e Auditimit.*

## V. PLAN VEPRIMI I REKOMANDIMEVE TË AUDITIT

Në zbatim të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik”, të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 4.1.12, sipas gjetjeve rekomandojmë :

**Gjetje:** Nga 10 rekomandime të lëna për ndjekje e zbatim nga auditimi i mëparshëm i ushtruara nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MB, Institucioni i Prefektit Korçë kishte realizuar plotësisht pesë rekomandime, janë pjesërisht të realizuara dhe në proces realizimi tre rekomandime dhe nuk janë realizuar dy rekomandime.

-Lidhur me raportimin periodik mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve, nga ana e Institucionit të Prefektit Korçë nuk është dërguar zbatueshmëria e rekomandimeve në vijimësi në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MB.

**Rekomandim:** Rekomandimet e pazbatuara dhe ato pjesërisht dhe në proces realizimi nga auditimet e mëparshme (trajtuar në pikën e parë të programit) të përfshihen në planin e veprimit të radhës duke përcaktuar afate dhe persona përgjegjës konkret për zbatimin e tyre dhe linjat e raportimit tek eprori për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e sistemeve në vijim. Menaxhimi i lartë i organizatës të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme dhe të raportojë periodikisht në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MB.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje:** KVVTP në 20 raste, (nga 78 kërkesa të hyra për shqyrtim) ka kthyer përgjigje administrative duke tejkaluar afatin 7 ditor nga data e protokollimit të kërkesës në institucion.

-Në përgjigjet administrative, nga ana e grupit të punës nuk përshkruhet i detajuar përcaktimi ligjor (neni dhe gërma e aktit ligjor) në mënyrë që të informohet kërkuuesi mbi arsyen e mos shqyrtimit administrativ të kërkesës.

**Rekomandim:** Specialisti/grupi i punës i ngarkuar për trajtimin e kërkesave të hyra nga institucione apo nga individë, të marrin masat që të shqyrtoj paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër i parashikuar nga ligji dhe në përfundim brenda 5 ditëve nga data e hyrjes së kërkesës të përgatisin përgjigjen administrative duke përshkruar të detajuar nenin dhe gërmën e aktit ligjor dhe të njoftojnë palën kërkuuese, mbi arsyet e mos shqyrtimit administrativ të kërkesës.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje:** KVVTP për kërkesën e ZVRPP Pogradec nr.5898, datë 07.11.2016 për shqyrtim AMTP-ve nr.6490, datë ska për sipërfaqen 6,700 m<sup>2</sup> dhe nr., e datë ska, për 1,000 m<sup>2</sup> në emër të shtetasit [REDACTED] NJ.Admin.Velcan, është mjaftuar vetëm me përgjigje administrative, pa bërë shqyrtimin dhe hetimin administrativ dhe në përfundim të shprehej me vendim për vlefshmërinë e AMTP-ve.

**Rekomandim:** KVVTP të marrë masat e menjëhershme për të filluar shqyrtimin administrativ të kërkesës nr.5898, datë 07.11.2016 të ZVRPP Pogradec, duke kërkuar pranë institucioneve shtetërore (ZVRRR Pogradec,

DAMT, si dhe njësisë vendore) dokumentacionin justifikues dhe në përfundim të shqyrtimit administrativ të shprehur me vendim për vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve nr.6490, datë ska për sipërfaqen 6,700 m<sup>2</sup> dhe nr., e datë ska, për 1,000 m<sup>2</sup> në emër të shtetasit [REDAKTUAR], NJ.Admin.Velcan.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Menjëherë

**Gjetje:** KVVTP kërkesave të Bashkisë Devoll u ka kthyer përgjigje administrative në mënyrë të përsëritur, duke ngarkuar padrejtësisht procedurat administrative të veprimitarisë së sajë, ndërkohë që objektet e kërkesave nuk janë kopetenc e KVVTP-së por detyrim për tu zbatuar nga vetë institucioni. Për këto raste KVVTP nuk duhej të pranonte shqyrtimin e kërkesës dhe duhej të propozonte kundravajtje administrative me gjobë ndaj titullarëve të institucionit.

**Rekomandim:** KVVTP për të gjitha kërkesat e paraqitura nga Institucionet shtetërore në mënyrë të përsëritur të cilat janë me mangësi dokumentacioni justifikues, të marrë masa që në përgjigjen administrative të përcaktojnë afate konkrete për plotësimin e të metave të konstatuara dhe në raste të përsëritjes pas afatit të përcaktuar të njoftojë subjektin për mos praninë të kërkesave dhe ndaj titullarëve të institucionit që kanë penguar veprimitarinë e KVVTP-së, të propozojë kundravajtje administrative me gjobë sipas nenit 13, pika 2 e Ligjit nr.9948, datë 07.07.2008.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje:** KVVTP nga 26 procedura me vendim “Pezullim të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të AMTP-ve”, ka ende në proces edhe 21 procedura pa u shprehur me vendim përfundimtar mbi vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve bazuar në dokumentet e paraqitura dhe të administruara në dosje sipas rastit, duke tejkaluar afatet e shqyrtimit dhe përfundimit të hetimit administrativ.

**Rekomandim:** KVVTP për 21 dosjet për të cilat ka marrë vendimin e pezullimit të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të AMTP-ve dhe për të cilat ka tejkaluar afatin maksimal 120 ditë të shqyrtimit dhe përfundimit të hetimit administrativ, të marrë masat që bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe të administruara në dosje të mos rikërkojë paraqitjen e dokumentacionit nga individët dhe ZVRPP por në mbledhjen e radhës së KVVTP-së të shprehur me vendim përfundimtar mbi vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve sipas rastit.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Menjëherë

**Gjetje:** KVVTP ka marrë vendimin nr.44, datë 31.10.2017, për pezullimin e procedurës administrative mbi vlefshmërinë ligjore të AMTP nr., ska, datë 10.04.1996, të lëshuar në emër të [REDAKTUAR] me sipërfaqe 13,100 m<sup>2</sup>, ndërkohë që duhej të merrte vendimin për pavlefshmëri të plotë të sipërfaqes 12,850 m<sup>2</sup> tokë, pasi provohet shkresërisht se përfituesit e AMTP-së nuk janë subjekte të përfitimit të tokës bujqësore pasi në datën 01.08.1991 nuk kanë qënë antarë të ish Koop.Bujqësore fshati Kuril.

**Rekomandim:** KVVTP bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë shqyrtimit të kërkesës së Bashkisë Devoll nr.64, datë 18.04.2017, të marrë masa që në mbledhjen e radhës të marrë vendimin e pavlefshmërisë së plotë të sipërfaqes 12,850 m<sup>2</sup> tokë bujqësore për AMTP-në nr.,ska, datë 10.04.1996, lëshuar në emër të shtetasit [REDAKTUAR] pasi shtetasi përfitues nuk ka qënë antarë i ish Koop.Bujqësore fshati Kuril në datën 01.08.1991, dhe kalimin në pronësi shtet.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Menjëherë

**Gjetje:** KVVTP ka marrë vendim pezullimit nr.32, datë 11.07.2016, “Për korigjim e AMTP-së nr.142, datë ska, lëshuar në emër të shtetasit [REDAKTUAR] Bashkia Maliq”, duke tejkaluar afatet e shqyrtimit ndërkohë që duhej të merrte vendimin e përfundimit të hetimit administrativ pasi pasuria nr.412/20 me sipërfaqe 510 m<sup>2</sup> nuk mund të ndahet se është brenda vijës kufizuese të fshatit Klocë dhe të njoftonte ZVRPP mbi zbatimin prej saj të kërkesave të VKM nr.994, datë 09.12.2015.

**Rekomandim;** KVVTP të marrë masat për të rishqyrtuar vendimin e pezullimit nr.32, datë 11.07.2016 i marrë për korigjim e AMTP-së nr.142, datë ska, (për të shtuar sipërfaqen e tokës bujqësore 576 m<sup>2</sup> e pa pasqyruar në AMT) lëshuar në emër të shtetasit [REDAKTUAR] Bashkia Maliq, dhe në mbledhjen e radhës,

KVVTP të marrë vendimin e përfundimit të hetimit administrativ dhe të njoftojë ZVRPP për vendimin e marrë mbi arsyet, provat shkreore si dhe sygjerimet ligjore dhe proceduriale që duhet të kryejë ZVRPP-ja.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Menjëherë

**Gjetje:** KVVTP për vitin 2017, ka programuar për kontroll të drejtpërdrejtë 4 ish-NB dhe zona me përparësi turizmi, njëkohësisht ka vazhduar edhe zbatimin e programeve të mëparshme për 4 subjekte të tjera. Janë marrë për shqyrtim gjithsej 820 AMTP nga të cilat edhe pse mangësitë janë të njëjste vendore dhe të ZVRPP, nuk janë kontrolluar 780 AMTP.

**Rekomandim:** KVVTP, të marrë masa, për të zbatuar programin vjetorë për kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, dhe të miratuar nga Komisioni Qeveritar i Tokës Tiranë. KVVTP për AMTP-të të cilat kanë mangësi dokumentacioni (*detyrim ligjor për tu plotësuar nga njësitë vendore dhe nga ZVRPP*) të marrë vendimin “Për pezullim të hetimit administrativ të AMTP-ve”, të përshkruaj në vendim arsyen dhe të njoftojë ZVRPP për të mos kryer veprime regjistrimi e paisje të përfituesve me certifikatë pronësie deri sa të plotësohen e dokumentohen mangësitë e konstatuara.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Menjëherë

**Gjetje:** Nga ana e KVVTP-së në zbatimin e programit të kontrollit për ish NB Drithas, të filluar nga viti 2013, ende nuk ka përfunduar shqyrtimin dhe hetimin administrativ të vlefshmërisë ligjore të 280 AMTP-ve të lëshuara nga ish komisioni i ndarjes së tokës për këtë NB. Ky mos përfundim shqyrtimi është rezultat i mosaktësimit dhe mosdhënies nga DRSSH-ja e datave të largimit nga puna të përfituesve të tokës në ish NB edhe pse kërkesat e KV-së kanë qënë të shpeshta.

**Rekomandim:** Për 280 AMTP e ish NB Drithas, si dhe për të gjitha rastet e konstatuara me mangësi për AMTP-të e ish NB Sheqeras (*për të cilat nuk jepet nga DRSSH Korçë data e largimit të përfituesit nga NB-ja apo në institucione të tjera*) që aktualisht janë në proces, nga ana e KVVTP-së duhet që të përfundojë shqyrtimi i tyre duke marrë vendimin “Për pezullim të hetimit administrativ të AMTP-ve” dhe për çdo rast në vendim të përshkruhet arsya dhe të njoftohet përveç përfituesit të AMT-së edhe ZVRPP, dhe Njësia Vendore (*Bashkia Maliq*) për të mos kryer veprimet mbi regjistrimin dhe procedurat e paisjes së këtyre përfituesve me certifikatë pronësie deri sa vetë përfituesit e AMTP-ve të kërkojnë në rrugë ligjore dhe të saktësojnë e vërtetojnë faktin juridik mbi datat e punësimit të tyre në ish NB dhe në Institucione shtetërore gjatë periudhës deri me datë 01.10.1992.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Menjëherë

**Gjetje:** KVVTP ka marrë vendim pezullimit nr.37, datë 04.08.2017, “Për korigjimin e 2 AMTP-ve nr.17862, datë 22.06.1992 me sipërfaqe totale 2,300 m<sup>2</sup> në emër të [redacted] si dhe AMTP-së nr.17699, datë 22.06.1992 me sipërfaqe totale 6,010 m<sup>2</sup> tokë në emër të [redacted] Korçë”, duke tejkalar afatet e shqyrtimit e hetimit administrativ ndërkohë që nuk duhej të fillonte shqyrtimin administrativ pasi nga ana e kërkuarit dhe institucioneve shtetërore nuk është paraqitur dokumentacioni ligjor i kërkuar në zbatim të pikës 3 gërmat d, c, pika 4 gërma ç, d të VKM-së nr.224, datë 19.02.2009.

**Për këtë gjetje nuk lëm rekomandim, pasi KVVTP është shprehur me vendim pezullimi por gjykojmë që KVVTP të njoftojë zyrtarisht shtetasin [redacted] për mosshqyrtimin e kërkesës nr.225, datë 05.12.2016, duke përcaktuar arsyet e mosshqyrtimit dhe fillimin e shqyrtimit pas paraqitjes së kërkesës së shoqëruar me dokumentacionin ligjor.**

**Gjetje:** Për periudhën e audituar nuk ka dalë urdhër i Prefektit dhe nuk janë kryer verifikime të drejtpërdrejta për ligjshmërinë e akteve të njëjste të qeverisjes vendore me karakter normativ. *Kjo në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.*

**Rekomandim:** Menaxhimi i lartë i organizatës të ngrejë një grup pune për verifikimin e drejtpërdrejtë të ligjshmërisë të akteve me karakter normative të Njësive të Qeverisjes Vendore, Verifikimi i drejtpërdrejtë të

ligjshmërisë të akteve me karakter normative të NJQV-re të jenë të programuara dhe të miratohen nga Titullari i Insitucionit dhe për çdo verifikim të mbahen aktet e kontrollit dhe dokumentet mbështetëse.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje:** Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile, nuk administron të dhëna mbi financimet e kryera sipas burimit të financimit, për situatat emergjente për trajtimin financiar të familjeve të dëmtuara në Qarkun Korçë, por administrohen të dhëna të ardhura me e-mail nga DPEC për vitin 2016 për 3 familje dhe për vitin 2017 për 4 familje.

11 **Rekomandim:** Menaxhimi i lartë të kërkojë shkresërisht të gjitha institucioneve të mundshme financuese të përballimit të situatave emergjente, të dhëna të plota mbi burimin e financimit, institucionin financiar, vlerën në lekë ose në natyrë të përfutur sipas familjeve/ personave.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje:** Dokumentacioni që prodhohet nga ana e këtij sektori, kalon nëpërmjet protokollit por nuk mbahet asnjë kopje nga sektori. Gjithashtu mungon një regjistër i brendshëm i proceseve të punës të kryera nga punonjësit e këtij sektori duke vështirësuar zgjidhjen e çështjesve sipas prioritetit dhe afateve ligjore.

12 **Rekomandim:** Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile të administrojë informacionet e marra mbi financimet e EC, të hapë një regjistër për përgjegjës administrimi e regjistrimi i të dhënave, ky regjistër të jetë i sekretuar dhe i protokolluar.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

13 **Gjetje:** Institucioni i Prefektit Korçë (Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave) nuk administron dokumentacionin justifikues (fletëdaljen) e aseteve të transferuara nga institucioni i prefektit, akt konfirmimin për marrjen në administrim të tyre nga Ministria e Mbrojtjes. **Rekomandim:** Institucioni i Prefektit Korçë (Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave) të kërkojë nga MM akt konfirmimin e marrjes në dorzim të aseteve të vendkomandave të cilat kanë kaluar në administrimin e prefektit të qarkut me vendimin nr. 515, datë 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventareve të pronave të cilat kalojnë në përgjegjësi administrim MM.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje;** Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile nuk ka realizuar trajnime të shtetasve për situata të emergjencave civile veprim në kundërshtim me pikën 12 të vendimit nr.655, datë 18.12.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile" të ndryshuar me Vendimn e KM, Nr.965, datë 02.12.2015, "Prefekti i qarkut, në bashkëpunim me qendrat e rekrutim-mobilizimit në qarqe me drejtuesit e reparteve të Forcave të Armatosura në territorin e qarkut, me Stacionin e PMNZSH-së dhe OJF-të, programon dhe realizon trajnimin e shtetasve për situata të emergjencave civile".

14 **Rekomandim:** Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile në bashkëpunim me qendrat e rekrutim-mobilizimit në qarqe me drejtuesit e reparteve të Forcave të Armatosura në territorin e qarkut, me Stacionin e PMNZSH-së dhe OJF-të, të programojë trajnimin e shtetasve për situata të emergjencave civile".

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje;** Nga ana e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse nuk janë mbajtur akt rakordime mujore me zyrat e gjendjes civile, përgjegjësi e nëpunësit zbatues.

15 **Rekomandim:** Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse në bashkëpunim me me zyrat e gjendjes civile të kryejë rakordime mbi sasinë gjendje të pullave çdo fund muaji.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje;** Njësia e prokurimit nuk ka të dokumentuar me dosje më vete procedurën shkresore dhe hapat e ndjekura për realizimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla, si dhe në procesverbalet e mbajtura nga njësia e prokurimit për argumentimin e fondit limit, nuk është detajuar dhe dokumentuar testimi i tregut (sipas rastit).

16 **Rekomandim:** Njësia e prokurimit të dokumentojë dhe administrojë të gjithë procedurën shkresore për realizimin e prokurimit blerje me vlera të vogla në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik" dhe Udhëzimit të APP-së "Për procedurat e prokurimit publik me vlera të vogla".

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje;** Në fund të vitit 2017, nga 29 punonjës në organikë të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr.3, datë 12.01.2016 "Për miratimin e strukturës e organikës të administratës së Prefektit të Qarkut Korçë", struktura ishte plotësuar me 27 punonjës, rezultuan 2 pozicione vakante (specialisti i sektorit të zhvillimit urban dhe emergjencave civile).

17 **Rekomandim:** Menaxhimi i lartë i Institucionit në bashkëpunim me DAP të kryejnë procedurat e duhura administrative për plotësimin në organikë të 2 pozicioneve vakante (specialisti i sektorit të zhvillimit urban dhe emergjencave civile).

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje;** Institucioni i Prefektit Korçë, ka në përgjegjësi administrimi 9 objekte ndërtimore nga të cilat 6 objekte (Prefektura Korçë, K.Rrethit Devoll, Kolonjë dhe Pogtadec, Gjendja Civile, Zyra Turizmit) janë regjistruar në ZVRPP për të cilat nuk është marrë çertifikata e pronësisë dhe për 3 objekte ndërtimore (garazhi Devoll, Kolonjë dhe Pogradec) nuk ishte bërë aplikimi akoma për ti regjistruar në ZVRPP "sipas të dhënave të VKM nr.1691 datë 10.10.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë...".

18 **Rekomandim nr:** Institucioni i prefektit të kërkojë nga ZVRPP çertifikatat e pronësisë për 6 objektet ndërtimore dhe për tre objektet të kryhet aplikimi për ti regjistruar dhe për marrjen e çertifikatës së pronësisë.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje;** Në fund të periudhës ushtrimore sipas bilancit institucioni ka detyrime të paarkëtuara në vlerën 66,109 lekë, vlerë që përfaqëson detyrimet e 3 ish punonjësve nga viti 2000.

19 **Rekomandim:** Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës 66,109 lekë, vlerë që përfaqëson detyrimet e 3 ish punonjësve nga viti 2000.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

**Gjetje;** Për periudhën objekt auditimi (viti 2016, 2017) institucioni sipas inventarit fizik dhe gjendjes kontabël ka 8 mjete transporti nga të cilat 5 mjete janë konstatuar nga komisioni i vlerësimit për jashtë përdorimit. Për këto mjete deri në momentin e përfundimit të auditimit nuk ka filluar procedura e përgatitjes së dokumentacionit dhe dërgimi nga ana e institucionit te organi qendror MB për të marrë miratimin, veprim në kundërshtim me pikën 103 të Udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Përgjegjësi e titullarit të institucionit dhe sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse

20 **Rekomandim:** Nga sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse të kryehet procedura e vlerësimit të mjeteve të transportit për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit me specialist të fushës dhe dokumentacioni ti përcillet organit Qendror për ndjekje të mëtejshme.

Niveli i prioritetit: I lartë

Afati i zbatimit: Në vazhdimësi

Në zbatim të pikës d, të nenit 12 "Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike" të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", si dhe të pikës 4.1.12 "Raportet e Auditimit dhe plotësimin të planit të veprimit nga njësia e audituar", pika 4.1.13 "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit" të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të miratuar me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 të MF, nga ana Juaj të hartohet e të miratohet Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit dhe të dërgohet zyrtarisht në DAB në MPB jo më vonë se 20 ditë

kalendarike nga marrja e Raportit Final të Auditimit (Kur nuk sillet plani i veprimit të rekomandimeve me persona dhe afate konkrete për zbatimin e tyre, në zbatim të pikës 4.1.13.1 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” të MAB, informohet Ministri mbi mos përmbushjen e përgjegjësiave ligjore të menaxhimit të lartë të subjektit të audituar).

Në zbatim të pikës 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB” të MAB, drejtuesi i njësisë së audituar duhet të caktojë një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e lëna nga AB, të komunikojë, të monitorojë dhe të informojë vazhdimisht në DAB në MPB, mbi zbatimin e rekomandimeve deri në zbatimin e plotë të tyre.

#### GRUPI I AUDITIMIT

Arbëresha ZYKA

Flamur ÇELA

Natasha URUÇI